



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 806/3 Prot.

Tiranë, më 11 . 08 . 2025

V E N D I M

Nr. 189, Datë 11 . 08 . 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 121 Regj., datë 22.05.2025³, e shtetasit A. V⁴, kundër Drejtorisë Vendore Tirana Veri, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “përkatësisë etnike”⁵

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në parashtrimet e sjella pranë Komisionerit, subjekti ankues, A. V, informon Komisionerin lidhur me problematikën e tij me DV ASHK Tirana Veri, për të cilën shprehet se:

“Kam vetëdeklaruar ndërtim informal të shtëpisë time, pranë ALUIZNI-t më datë 25.03.2005 (nr. prot. 1986) dhe më datë 17.11.2006 (nr. prot. 5406), të dyja për të njëjtin objekt, dhe kam ndjekur të gjitha procedurat e kërkuara për të fituar të drejtën e legalizimit.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Plotësuar nga ankuesi me e-mailin e datës 27.05.2025.

⁴ Përfaqësuar nga znj. M. V, drejtuese e Qendrës për të Drejtat e Gruas Rome, bazuar në deklarinimin me shkrim të ankuesit.

⁵ Ankuesi vetëdeklarohet si pjesë e pakicës rome në Shqipëri.

Megjithatë, pavarësisht matjeve të shumta të kryera nga institucionet përgjatë viteve, procesi ka mbetur pezull pa asnjë vendim të qartë. Gjatë kësaj periudhe, kam paguar rregullisht të gjitha taksat dhe tarifat e nevojshme.

Më datë 29.08.2011, mora një njoftim nga ALUIZNI për pagesën e legalizimit, të cilën e shlyeva plotësisht, por procesi sërish nuk u finalizua.

Në vitin 2019, më kërkuan një deklaratë noteriale për funksionin e objektit, e cila u dorëzua menjëherë, por nuk pati asnjë zhvillim tjetër.

Në maj 2022, me ndihmën e Qendrës për të Drejtat e Gruas Rome, bëmë një kërkesë të re për lehtësimin e procedurave të legalizimit. Fillimisht, drejtuesit e ASHK-së shfaqën vullnet të mirë dhe u ra dakord të niste procesi për pesë familjet e para, përfshirë dhe familjen time (mua).

Në janar 2023, u kryen matjet e banesave tona nga punonjësi i ASHK-së, por pas ndërrimit të titullarit të ASHK-së, procesi ngeci sërish dhe asnjë prej nesh nuk mori përgjigje mbi statusin e legalizimit.

Sipas informacionit të marrë nga Qendra për të Drejtat e Gruas Rome, ajo ka kontaktuar disa herë ASHK-në në emrin tonë dhe i është kthyer përgjigje se, për shkak të numrit të madh të aplikimeve dhe ngarkesës në procesimin e tyre, procesi ka marrë kohë. Zonat po verifikohen me radhë dhe ne duhet të presim fillimin e verifikimit në zonën ku kemi ndërtuar.

Ndërkohë që, fqinjët e mi, R. A, V. S, A. S, A. V dhe Xh. B, të cilët kanë ndërtuar dhe vetëdeklaruar banesat e tyre në të njëjtën periudhë si ne, tashmë kanë përfunduar me sukses procesin e legalizimit. Madje, A. Bi ka nisur procesin e legalizimit edhe për një shtesë ndërtese të legalizuar 5-6 vitet e fundit, ndërsa banesa ime dhe ato të familjeve të tjera rome, vazhdojnë të mbeten në pritje, pa asnjë përparim në procedurë.

Kjo dëshmon për trajtim të pabarabartë dhe diskriminues ndaj meje dhe familjeve rome dhe egjiptiane. Jam i bindur se diskriminohem për shkak të përkatësisë sime etnike. Kërkesat e mia për përfundimin e procesit të legalizimit neglizhohen vazhdimisht, dhe procesi i legalizimit vazhdon pengohet. Jam ankuar disa herë gjatë vitit 2024 në Zyrën e Bashkëqeverisjes për zvarritjen e procesit të legalizimit.”

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminimin nga ana e DV ASHK Tirana Veri, për shkak të përkatësisë etnike të tij si rom, si dhe të merren masa për përfundimin e procesit të legalizimit të banesës së tij.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me

HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 806/1, datë 25.05.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga ASHK dhe DV ASHK Tirana Veri, lidhur pretendimet e palës ankuese.
2. Nëpërmjet shkresë me nr. 5450/3 prot., datë 24.07.2025, të DV ASHK Tirana Veri, Komisioneri është informuar se:

“Pas verifikimit lidhur me rastin e subjektit ankues, rezulton se, për subjektet A. V dhe M. V, është emëtuar vendimi për legalizimin e ndërtimit pa leje me nr. 6790, datë 14.04.2025, për objektin informal të ndërtuar në Njësinë Administrative nr. 11, të vetëdeklaruar me nr. 5406 prot., datë 17.11.2006.”

3. Përmbajtja e shkresës sipërcituar, është konfirmuar nga ana e subjektit ankues, nëpërmjet e-mailit datë 13.06.2025⁶, dërguar Komisionerit, ku ka depozituar edhe vendimin nr. 6790, datë 14.04.2025 “Për legalizimin e ndërtimit pa leje”,

Në Vendimin e mësipërm, të DV ASHK Tirana Veri, ndër të tjera, citohet se:

“... në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të ndërtimit pa leje të llojit Objekt, përfshirë në procedurat e legalizimit nëpërmjet nr. 5406 prot., datë 17.11.2006, me Numër Unik (INDEX): 12_289454 poseduar nga: A. V dhe M. V, i ngritur në Njësinë Administrative nr. 11, Bashkia Tiranë, me Nr. Pasurie 2/219, Zona Kadastrale 8320, Sipërfaqe ndërtimore 269.6 m2 banim, social – ekonomik, Nr katesh objekt 2 kate mbi toë, Sipërfaqe e parcelës ndërtimore 303 m2....

⁶ Administruar si provë në dosjen e subjektit ankues.

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

DVASHK Tirana Veri, vendosi: “Legalizimin e ndërtimit pa leje, përfshirë në procedurat e legalizimit nëpërmjet aplikimit nr. 5406 prot., datë 17.11.2006, me Numër Unik (INDEX): 12_289454, në zonën kadastrale nr. 8320, poseduar nga: A. V dhe M. V”.

4. Në e-mailin e datës 04.08.2025, pala ankuese, dakordësohet dhe pohon sa më sipër, lidhur me vendimin e legalizimit të objektit të ndërtuar pa leje, duke shtuar se:

“... kjo çështje duhet të vazhdojë të ndiqet nga Zyra juaj, të paktën deri në momentin kur leja e legalizimit, e lëshuar më datë 14.04.2025, të regjistrohet në hipotekë dhe të fitohet pronësia, që është edhe objektivi final i gjithë kësaj përpjekjeje...”

Komisioneri vlerëson të theksojë se, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të subjektit ankues, (depozituara në ankesën me nr. 121 regj., date 22.02.2025, pranë KMD-së), objekt i gjykimit e analizës të kësaj vendimmarrje, janë ato pretendime mbi bazën e të cilave janë investuar palët gjatë shqyrtimit të ankesës, dhe për e mbi të cilat ka vijuar procedura hetimore, kundrejt subjektit për të cilin ka pretenduar se e ka diskriminuar.

Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se të gjitha pretendimet që nuk janë objekt i ankesës me nr. 121 regj., datë 22.02.2025, nuk do të jenë objekt i analizës së këtij vendimi.

Për rrjedhojë, pretendimet e palës lidhur me regjistrimin e lejes së legalizimit të objektit në fjalë, janë pretendime të reja, të ndryshme nga pretendimi për të cilin KMD është investuar në këtë proces administrativ, dhe mbi të cilat ka kryer hapat procedural dhe hetimin, dhe nuk mund të shqyrtohen në kuadër të ankesës me nr. 121 regj/2025.

Në këtë kontekst, duke iu rithyer rrethanave konkrete të çështjes, Komisioneri vlerëson se, kërkimi i palës ankuese, ose ajo që pala ankuese kërkon të arrijë ose të sigurojë, nëpërmjet paraqitjes së ankesës objekt shqyrtimi (me nr. 121 regj/2025) dhe fillimit të kësaj procedure administrative është përmbushur, nëpërmjet miratimit të vendimit nr. 6790, datë 14.04.2025 “Për legalizimin e ndërtimit pa leje”, të DV ASHK Tirana Veri.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Neni 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative (K.P.A), ka parashikuar se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb, pasi u zgjidh problematika e adresuar pranë Komisionerit.

Për rrjedhojë është përmbushur edhe qëllimi i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për sigurimin e të drejtës së çdo personi për:

- “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Përfundimisht, referuar sa më sipër, si dhe duke mbajtur në konsideratë:

- Masat efektive konkrete të ndërmarra nga ana e DV ASHK Trana Veri, për legalizimin e banesë së palës ankuese, (*Legalizimin e ndërtimit pa leje, përfshirë në procedurat e legalizimit nëpërmjet aplikimit nr. 5406 prot., datë 17.11.2006, me Numër Unik (INDEX): 12_289454, në zonën kadastrale nr. 8320, poseduar nga: A. V dhe M. V - Sipërfaqe ndërtimore 269.6 m2 banim, social – ekonomik, Nr katesh objekt 2 kate mbi toë, Sipërfaqe e parcelës ndërtimore 303 m2*).
- Përmbushjen e qëllimit për të cilin ishte iniciuar ankesa konkrete, si dhe
- Qëllimin parandalues të LMD-së, ndërgjegjësimin e ndërmjetësimin për zgjidhje miqësore e zbatim efektiv të tij, dhe jo vetëm karakterin konstatues dhe ndëshkues të vendimmarrjeve të KMD-së;

Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 121 regjistri, datë 22.05.2025, të paraqitur nga z. A. V, duhet të deklarohet e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, për shkak se objekti dhe qëllimi i ankesës për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur, për sa kohë që objekti dhe qëllimi që pala ankuese ka kërkuar të realizojë nëpërmjet kësaj procedure administrative është përmbushur⁷.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenet 32 e 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 121 regjistri, datë 22.05.2025, të z. A. V, pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.

⁷ Për analogji citojmë vendimet e KMD-së: Nr. 107/2024, Nr. 181/2024, Nr. 2, datë 06.01.2025.

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA